



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:043704

Datë: 24.01.2025

Numri i dokumentit: 06756244

KF.nr.821/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në konfliktin tregtar administrativ të paditësit NTP “Doqi”, me numër unik identifikues 810639859 dhe seli në Ferizaj, të cilin me autorizim e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners”, me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulim vendimi, objekt i çështjes ri vlerësim i shpenzimeve të transportit, vlera e kontestit e pa përcaktuar, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur me datë 16.01.2025 në mungesë të përfaqësuesit të palës paditëse e në prani të përfaqësueses së palës së paditur B. G., mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditësit NTP “Doqi”, me numër unik identifikues 810639859 dhe seli në Ferizaj.
- II. ANULOHET aktvendimi 01.3.2.2/21070 i datës 15.12.2021 i Doganës së Kosovës dhe lënda KTHEHET NË RISHQYRTIM DHE RIVENDOSJE tek e paditura.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi NTP “Doqi”, përmes përfaqësuesit të autorizuar më datës 03.03.2022 ka paraqitur padi me të cilin ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë. Paditësi me padi ka kontestuar vendimin përfundimtar të doganës me të cilin i është refuzuar ankesa ndaj rivlerësimit të shpenzimeve të transportit. Ka arsyetuar se ka ofruar prova të mjaftueshme se meqenëse aplikohet CIF pariteti, shitësi i bartë shpenzimet e transportit detar e të cilën e vërteton me kontratë të shitblerjes, fatura dhe dokumentet tjera të bashkangjitura

padisë. Gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj si të bazuar kërkesëpadinë, të anuloj Aktvendimin e të paditurës dhe ta detyroj të paditurën që ti kthej mjetet monetare të paguara më tepër në emër të shpenzimeve të transportit së bashku me kamatën vjetore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë. Për shpenzime të procedurës nuk është deklaruar. Gjatë shqyrtimit kryesor, përfaqësuesi i paditësit nuk prezantoi.

Përfaqësuesja e autorizuar e paditësit, përmes emailit të dërguar më 15.01.2025, i është drejtuar zyrtares ligjore Arta Hyseni duke kërkuar që seanca e planifikuar për datën 16.01.2025 në orën 11:00 të shtyhet për pasdite, konkretisht pas orës 13:00. Arsyeja e paraqitur ka qenë fakti se në orën 10:00 dhe 11:00 të po asaj date janë caktuar të mbahen dy seanca të tjera te gjyqtarit Fisnik Nuli, në të cilat janë ftuar të marrin pjesë edhe ekspertë. Në email, përfaqësuesja ka theksuar se edhe përfaqësuesit e Doganës janë njoftuar përmes emailit dhe ka shprehur bindjen se kjo nuk do të përbënte problem për ata. Zyra e gjyqtares, përmes emailit, i është përgjigjur kërkesës së përfaqësueses së paditësit duke e njoftuar se seanca nuk do të shtyhet dhe do të mbahet në datën dhe orën e caktuar. Më 16.01.2025, parashtresa është dorëzuar fizikisht në zyrën e gjyqtares nga Zyra e Menaxhimit të Lëndëve (ZML) në orën 09:50.

E paditura në përgjigje në padi e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. Më tej ka shtuar se vendimi i atakuar është marr konform dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marr me shkelje ligjore nuk qëndron, me arsyetimin se vendimi i atakuar është marr konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme duke i propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoi si të pabazuar dhe ta lë në fuqi vendimin kontestues si të ligjshëm. Gjatës seancës së shqyrtimit kryesor përfaqësuesja e të paditurës ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit duke shtuar se mbesin në tërësi pranë përgjigjes në padi si dhe sqarimeve dhe elaborimeve si në arsyetimin e vendimit të nxjerrë nga dogana pasi në procedurën e administrimit të provave dokumentacioni përcjellës i mallit është vlerësuar si provë e pamjaftueshme për arsye se në faturën mallit mungon informacioni i plotë i dërguesit, web site, numri i regjistrimit fiskal e të tjera, po ashtu mungon deklarata eksportuese e shtetit eksportues. Më tej ka theksuar se informacionet të cekura në faturë po ashtu mungojnë edhe në kontratën e deklaruar nga paditësi, dhe në këtë kuptim dogana ka bërë vlerësimin e provave që ka prezantuar subjekti këtu paditësi me provat që kanë shërbyer për referencë për vlerësimin e shpenzimeve të transportit duke u bazuar në nenin 3 të UA 06/2015 duke mos pranuar paritetin CIF dhe duke shtuar shpenzimet e transportit bazuar në shtojcë dy të

UA 06/2015 të ndryshuar dhe plotësuar me vendimin e qeverisë nr.17/36 e dt 22.09.2021. Gjykatës i ka propozuar që kontrata në gjuhën angleze të mos trajtohet si provë pasi që nuk është në gjuhën zyrtare. Për shpenzime të procedurës nuk është deklaruar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor-publik të datës 02.12.2024 ka administruar provat si në vijim: Aktvendim 01.3.2.2/21070 të dt 15.12.2021, Ankesë në doganë e datës 27.10.2021, DUD R 27981 i datës 28.09.2021, Faturë nr 4381/2021 dhe faturë nr. ZH20210604A-AA e dt 04.06.2021, Packing list Proces mbi përcaktimin e vlerës së mallrave, Faturë e dt 20.07.2021 dhe packing list, Pagesë ndërkombëtare e datës 13.08.2021, Bill of landing.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigjes në padi, deklarimeve në seancë, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, vlerësoi secilën provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, dhe duke u mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë kontest tregtar administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar-administrativ, përfshirë deklarimet në ankesë, shkresat e lëndës, aktvendimin kontestues dhe deklarimet në seancën e shqyrtimit gjyqësor, Gjykata ka konstatuar se nuk është kontestuar fakti që Zyra e Pranimit Qendror i ka kontestuar paditësit lartësinë e shpenzimeve të transportit sipas Deklaratës Unike Doganore R27981/28.09.2021 dhe R27985/28.09.2021, duke u bazuar në Vendimin e Qeverisë nr. 17/36, datë 22.09.2021. Po ashtu, nuk është kontestuar se paditësi ka kundërshtuar këtë vendim, ndërsa kërkesa e tij për rishqyrtim është refuzuar nga e paditura me aktvendimin nr. 01.3.2.2/21070. Kundër këtij aktvendimi, si vendim përfundimtar i marrë në procedurën administrative të shkallës së dytë, paditësi ka ushtruar padi, duke inicuar kështu këtë kontest tregtar-administrativ.

Çështje kontestuese mes palëve mbetet nëse për paritetin CIF, e paditura duhet të marrë për bazë Shtojcën 2 të Udhëzimit Administrativ nr. 06/2015, të ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin e Qeverisë nr. 17/36.

Nga arsyetimi i vendimit kontestues gjykata konstaton se e paditura ka refuzuar ankesën e paditësit për arsye se Sektori i Pranimit Qendror ka vepruar drejtë kur ka kontestuar paritetin CIF të deklaruar, ashtu që janë shtuar shpenzimet e transportit detar për kontejner bazuar n

shtojcën 2 të U/A nr.06/2015 të ndryshuar dhe plotësuar me vendimin e qeverisë 17/36 datë 22.09.2021 i cili vendim ka ndryshuar/plotësuar vlerën e shpenzimeve të transportit të mallrave të importuara konform listës së çmimeve të përditësuara si pjesë përbërëse e këtij vendimi, kjo ka rezultuar pas hulumtimeve të bëra nga Sektori i Vlerës së Doganës dhe krahasimit të çmimeve, në veçanti për periudhën 2020/2021, është evidentuar një ngritje e theksuar e kostos së shpenzimeve të transportit, kryesisht nga Azia të determinuar nga faktorë të ndryshëm ekonomik. Më tej ka arsyetuar se subjekti në procedurë ka paraqitur dokumentacion në përpjekje për të provuar se vlera e deklaruar e shpenzimeve është vlerë e paguar për mallin lëndor, mirëpo në procedurën e administrimit të provave, dokumentacioni përcjellës i mallit lëndor është vlerësuar si provë e pamjaftueshme për arsye se në faturën e mallit mungon informacion i plotë i dërguesit, website, numri i regjistrimit fiskal etj, po ashtu këto informacione mungojnë edhe në kontratën e deklaruar nga subjekti, mungon edhe deklarata eksportuese të shtetit eksportues, pra subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion të kompletuar dhe të harmonizuar dhe në këtë kuptim Dogana e Kosovës ka bërë vlerësimin e provave që ka prezantuar subjekti ankimor me provat që ka shërbyer për referencë për vlerësimin e shpenzimeve të transportit.

Gjykata nga aktvendimi kontestues vëren se ai përmban të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, të metat e tilla konsistojnë në faktin se arsyetimi i vendimit lidhur me rivlerësimin e shpenzimeve të transportit nuk është i mjaftueshëm dhe nuk përputhet me dispozitat e Kodit Doganor dhe të Akcizave, aq më tepër me UA 06/2015 i ndryshuar me vendimin e Qeverisë 17/36 të datës 22.09.2021 i cili vendim ka ndryshuar/plotësuar vlerën e shpenzimeve të transportit detar dhe kontejnerëve në shtojcën 2 të UA nr.06/2015.

Për gjykatën, është e papranueshme që të mos shqyrtohet validiteti i dokumentacionit përcjellës të mallit lëndor, vetëm për faktin, siç theksohet në arsyetimin e vendimit kontestues, që i është dhënë prioritet kriterit të analizës së riskut rreth deklarimit të paritetit dhe shpenzimeve të transportit si rezultat i ngritjes së theksuar të shpenzimeve të transportit në tregun global, sidomos nga Kina. Gjykata gjithashtu vlerëson se nuk mund të merret si arsye për refuzimin e dokumentacionit fakti që paditësi nuk ka bashkangjitur deklaratën eksportuese dhe mungojnë të dhënat e eksportuesit, siç janë website-i, etj.

Gjykata konsideron se në rastin konkret e paditura Dogana e Kosovës është dashur që ti shqyrtoj pretendimet e paditësit në kuptim të vlerësimit të gjithë dokumentacionit të mallit për Deklaratën

Unike Doganore kontestuese, mirëpo në këtë rast siç shihet në arsyetimin e vendimit kontestues e paditura vendimin e vet e nxjerr duke u mbështetur në UA 06/2015 i ndryshuar me vendimin e Qeverisë 17/36 e i cili i referohet shpenzimeve të transportit detar duke konkluduar se nuk janë deklaruar si duhet dhe duke e rivlerësuar në bazë të dhënave shtojcës 2 të UA nr.05/2015, veprim ky i cili është në kundërshtim me dispozitat e nenit 134 të Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, që parasheh: *krahas kërkesave të nenit 48 të këtij Ligji, arsyetimi i aktit administrativ që zgjidh ankesën, do të përmbajë gjithashtu vlerësimet e të gjitha pretendimeve të parashtruara nga pala në ankesë.*

E paditura është dashtë të vlerësoj mallin lëndor në kuptim të metodave të vlerësimit 33-35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109, dhe të nxjerr konstatimin se a harmonizohet vlera e dokumentacionit përcjellës të mallit lëndor. Të vlerësoj bazën ligjore të arsyetuar gjatë rivlerësimit e cila sipas gjykatës nuk mund të gjej zbatim në rastin konkret. Gjykata konstaton se nga e paditura nuk është bërë një vlerësim i drejt i faturës së mallit lëndor me transaksionet bankare dhe dokumentet përcjellëse. Në procedurën e konfliktit administrativ gjyqësor paditësi i ka prezantuar gjykatës Deklaratat Unike Doganore, faturat përcjellëse të mallit doganor, transaksionet bankare.

Gjykata, nga shkresat e lëndës, konstaton se paditësi ka ofruar dokumentacionin e mjaftueshëm, sipas të cilit vërtetohet se fatura përmban paritetin CIF Selanik. Mospranimi i paritetit CIF nga e paditura nuk është arsyetuar. Për gjykatën, është i papranueshëm vetëm arsyetimi se veprimi i Zyrës Qendrore është i drejtë, pa sqaruar nëse e paditura ka gjetur prova për të dëshmuar se importuesi këtu paditësi ka paguar shpenzimet e transportit detar.

Në rastin konkret, për gjykatën është e pamjaftueshme të rivlerësohen shpenzimet kur fatura përmban paritetin CIF Selanik, dhe pa prova të bazuara, të ngriten shpenzimet me arsyetimin se mungon deklarata eksportuese dhe të dhëna për website-in apo numrin fiskal të eksportuesit, të cilat nuk janë të parapara si dokumente dhe të dhëna si kushte për të njohur vlerën reale të mallrave, përkatësisht shpenzimeve të transportit të deklaruara nga paditësi.

Me Dispozitën ligjore të nenit 33 par 1 të KDAK-së është përcaktuar se *“Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, i përshtatur, sipas nevojës, në përputhje me nenet 36 dhe 37”.*

Tutje, në paragrafin 3 të nenit 33 të KDAK-së përcaktohet se *“Çmimi vërtetë i paguar apo i pagueshëm është pagesa e plotë e bërë ose që duhet bërë nga blerësi për shitësin ose në dobi të këtij të fundit për mallin e importuar dhe që përfshin të gjitha pagesat e bëra ose që duhen bërë, si kusht i shitjes së mallrave të importuara nga blerësi për shitësit, ose nga blerësi për një palë të tretë për ta përmbushë obligimin ndaj shitësit. Pagesa mund të mos bëhet patjetër në formën e transferit të parave. Pagesa mund të bëhet me anë të letrave të kredisë ose ndonjë mjete tjetër të dakorduar të pagesës dhe mund të bëhet drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë”*. Ndërsa, se cilat dokumente duhet ti bashkëngjiten deklaratës doganore për vendosje në qarkullim të lirë të mallit, është e rregulluar me nenin 123 par. 1 pika (a) të UA nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe Akcizave nr.03/L-109, ku decidivisht përcaktohet se *“a) fatura në bazë të së cilës deklarohet vlera doganore e mallrave, siç kërkohet sipas nenit 91 të këtij akti”*.

Gjykata i kërkon të paditurës, Doganës së Kosovës, që në ri-procedurë, përpara se të bëjë rritjen e vlerës së shpenzimeve të transportit, të deklarohet lidhur me faktin nëse pariteti i deklaruar CIF Selanik është kontestues në rastin konkret. Ky paritet përcakton që shpenzimet e transportit përfshijnë transportin tokësor, dhe në rastin konkret, transporti tokësor duhet të konsiderohet nga Selaniku deri në destinacionin përfundimtar, Ferizaj, duke përjashtuar shpenzimet e transportit detar nga Kina në Selanik.

Nëse marrëveshja mes palëve përcakton se pariteti CIF është i vlefshëm, gjykata vlerëson se nuk mjafton vetëm konsiderimi i shpenzimeve si të ulëta për të aplikuar të dhënat sipas udhëzimit të Qeverisë. Një udhëzim i tillë mund të zbatohet vetëm në rastet kur nuk ekziston një transaksion i vlefshëm dhe kur deklarohet një paritet tjetër, siç është pariteti FOB, ku shpenzimet e transportit i bart importuesi.

E paditura duhet të bëjë një vlerësim të drejtë dhe të plotë të dokumentacionit të paraqitur dhe të konstatojë nëse shpenzimet e transportit janë deklaruar në përputhje me nenin 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave. Në këtë kontekst, paditësi i ka bashkëngjitur gjykatës faturën e transportit nga Selaniku në Ferizaj, por e paditura nuk e ka arsyetuar këtë provë. Përkundrazi, ajo e ka kontestuar faturën vetëm në kuptim të shpenzimeve të transportit, ndërsa e ka pranuar atë sa i përket vlerës së mallrave.

Konform të lartcekurave, gjykata konkludon se në këtë konflikt administrativ ekzistojnë të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, ku ka rezultuar të mos dihen arsyet e mos kontestimit të vërtetësisë së dokumentacionit të mallit të prezantuar në procedurën administrative të ankesave.

Andaj në këtë drejtim gjykata bazuar në nenin 43 par.2 të Ligjit Nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative (LKA) e detyron organin e paditur Dogana e Kosovës në Prishtinë, që në ri procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në arsyetim të këtij aktgjykimi, duke pasur parasysh se nuk janë vlerësuar në mënyrë të drejt të gjitha faktet që kishin me ndikuar në vendosjen e drejt të çështjes.

Vërejtjet e gjykatës janë te obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65, të LKA-së.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi konform nenit 64 të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 43 par. 2 të LKA-së, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.821/22, datë 16.01.2025

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.